



Prishtinë, 14 tetor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1178_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në parcelën ngastra kadastrave Nr. 026-0 dhe 025-0, ZK Ballofc, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** në Komunën e Podujevës, të datës 26.08.2019 me nr. prot. 447/2019 të aplikuesit N.T.P.“AMG”, me adresë: fsh.“Ballofc”, Komuna Podujevës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 14 tetor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET-** kërkesa e aplikuesit N.T.P.“AMG”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastra kadastrave Nr. 026-0 dhe 025-0, ZK Ballofc, me kapacitet të instaluar prej **30 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Podujevës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi N.T.P.“AMG”, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR- 2005281 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi N.T.P.“AMG”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


A r s y e t i m



- ZRRE, me datë 26.08.2019 nga aplikuesi N.T.P.“AMG”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrale katastrale Nr. 026-0 dhe 025-0, ZK Ballofc, me kapacitet të instaluar prej **30 kW**, që do të vendosen mbi objekt, shifra e konsumatorit DPR-2005281, Komuna e Podujevës.
 - Aplikuesi, s’bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 5541 të datës 21.08.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 07-350/02-0013271/19 të datës 20.02.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Podujevës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit N.T.P.“AMG”, dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e objektit të ndërtuar në parcelën ngastrale kadastrave Nr. 026-0 dhe 025-0, ZK Ballofc, me kapacitet të instaluar prej **30 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Podujevës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së